

Kredi Personale me normë interesi të pandryshueshme

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27;
Kutia postare nr. 8319
1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe reziqet e

"Kredi personale me të ardhura 100% të deklaruarra & pagamarrës në ISBA"

Karakteristikat e "Kredi personale me të ardhura 100% të deklaruarra & pagamarrës në ISBA"

Kredia personale ofrohet për klientët individë me qëllim për të mbuluar nevojat e tyre për likuiditet.

Kjo kredi ofrohet në monedhën vendase në Lek dhe në monedhë të huaj Euro.

Sipas Kodit Civil, Kontrata e Kredisë është e vlefshme vetëm nëse të dyja palët (Kredidhënësi dhe Kredimarrësit) bien dakord formalisht në lidhje me të, prandaj në rastin e llogarive me më shumë se një titullar llogarie, është e detyrueshme marrja e pëlqimit të të gjithë titullarëve të llogarisë.

- Klienti duhet të deklarojë anëtarët e familjes dhe ky informacion duhet të vërtetohet nëpërmjet çertifikatës familjare të cilën duhet të paraqesë klienti;
- Limiti maksimal për këtë produkt përcaktohet për familje dhe jo individë;
- Megjithëse kredia ofrohet për shumë qëllime, klienti duhet të deklarojë qëllimin e kredisë;
- Kredia duhet të jetë ekskluzive dhe vetëm në favor të aplikantit;
- Nuk është e nevojshme për bashkë-kredimarrës nëse të ardhurat e aplikantit përmbushin kriteret e kërkuara;
- Nëse klienti është i martuar, bashkëshortja/bashkëshorti do të konsiderohet si bashkë-kredimarrës.

Tregu i synuar

Klientela e synuar për këtë produkt janë:

- Klientët individ me të ardhura të rregullta dhe një historik të mirë kredie;
- Klientët me të ardhura të qëndrueshme nga puna, të ardhura të rregullta nga qeraja dhe pronarë/administratorë të bizneseve;
- Vetëm rezidentët shqiptar.

Opsione të tjera shtesë

Klienti mund të përdor shumën që i jepet sipas diskrecionit të tij/ pa qenë e nevojshme paraqitja e dokumentacionit mbështetës. Ai mund të përdor kredinë personale me qëllim për të mbuluar nevojat e tij për likuiditet.

Pjesëmarrja e Bankës për mbulimin e nevojave të klientëve për likuiditet është 100% vetëm nëse shuma është më e vogël se shuma maksimale që lejohet për këtë produkt.

Dokumentet e nevojshme

- Pasqyra e llogarisë 6 mujore për të vërtetuar të ardhurat nga paga;
- Nëse të ardhurat janë nga qiratë, atëherë klienti me:
 - të ardhura të deklaruarra 100% duhet të paraqesë pasqyrën e llogarisë vetëm për një periudhë 6 mujore për të vërtetuar të ardhurat e rregullta dhe një kopje të kontratës së qirasë;
 - të ardhura të deklaruarra jo 100% duhet të paraqesë pasqyrën e llogarisë për një periudhë 6 mujore për të vërtetuar të ardhurat e rregullta mujore, kopje të kontratës së qirasë, dokument të pronës dhe foto të pronës.
- Pasqyra e llogarise 1 vjecare per te vertetuar kreditime ne banka te tjera (opsionale);
- Certifikatë e freskët familjare;
- Kopje e dokumentit të vlefshëm të identifikimit;
- Të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Kredisë (National Credit Bureau) në formatin PDF, i cili shkarkohet nga Regjistri Kombëtar i Kredisë (National Credit Bureau) jo më vonë se 5 ditë pune nga data e dorëzimit dhe kërkimi duhet të kryhet me emrin e saktë të babait dhe datën e saktë të lindjes;

- Për pronarët/administratorët e biznesit, ekstrakt të QKR lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga data e dorëzimit si dhe deklaratën përfundimtare të tatimit mbi fitimin për vitin e fundit;
- Libreza e energjisë elektrike/ujit ose faturat e fundit.

Shërbime suplementare

Shërbimi shtesë që ofrohet së bashku me Kredinë Personale është llogaria rrjedhëse e kredisë e cila do të përdoret ekskluzivisht për transaksione të lidhura me kredinë.

Rreziqet e Kredise personale me te ardhura 100% te deklaruarra & pagamarres ne ISBA

Në rastin kur kredia personale është dhënë në Euro dhe të ardhurat janë në Lekë, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e kursit të këmbimit EUR/ LEK.

Struktura e çmimit

Norma e interesit (në përqindje në vit)/ E pandryshueshme për të gjithë afatin.

Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

Norma e Interesit (NI)

Norma vjetore e interesit që Huamarrësi është i detyruar ti paguaj Bankës aplikohet çdo vit; numri i ditëve /360 (treqind e gjashtëdhjetë) dhe llogaritet për shumën e kredisë (Principalin).

Interesi vjetor përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- një kuotë e caktuar fikse dhe e pandryshueshme; si dhe
- norma bazë e interesit, e cila është një kuotë e ndryshueshme, e barabartë me normën vjetore të indeksit të EURIBOR-it/ Bono Thesari -it.

Norma minimale e interesit (NMI)

NMI do të thotë vlera më e ulët vjetore, nën të cilën 'Norma Vjetore e Interesit' nuk do të llogaritet në asnjë rast, megjithëse si rezultat i ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit', 'Norma vjetore e interesit' do të rezultojë në një vlerë më të ulët (për shkak të aplikimit të formulës: Norma Bazë e Interesit + Marzhin).

Norma vjetore e interesit do të jetë e barabartë me normë më të lartë vjetore midis Normës së Interesit (NI) dhe Normës Minimale të Interesit (NMI).

Kredi personale (Kredi personale me te ardhura 100% te deklaruarra & pagamarres ne ISBA)

Plani Bazë Standard për Klientin	NI	NMI
Kredi Personale në LEK	Kohëzgjatje 1 vit: 4.2% Kohëzgjatje 2 vjet: 7% Kohëzgjatje 3 vjet: 8% Kohëzgjatje 4 vjet: 9% Kohëzgjatje 5 vjet: 9% Kohëzgjatje 6 vjet: 9.5% Kohëzgjatje 7 vjet: 9.5%	N/A
Kredi Personale në EUR	Kohëzgjatje 1 vit: 5% Kohëzgjatje 2 vjet: 6% Kohëzgjatje 3 vjet: 7% Kohëzgjatje 3 deri në 5 vjet: 8% për 3 vitet e para, 9% për vitet e mbetura të kredisë; Kohëzgjatje 5 deri në 7 vjet: 8.5% për 3 vitet e para, 9.5% për vitet e mbetura të kredisë	N/A
Shuma që mund të financohet dhe afati		
Karakteristikat		
Shuma minimale e financimit		50,000 LEK/ EUR 500
Shuma maksimale e financimit		2,200,000 LEK/ EUR 18,000
Shuma maksimale e financimit për klientët me të ardhura 100% të deklaruarra dhe që janë pagamarrës me page mujore \geq 1,000 EUR/ekuivalente në LEK		3,000,000 LEK/ 28,000 EUR

Afati

Deri në 7 vite

Shembull ilustrativ për llogaritjen e kështit të kredisë

Shembulli ilustrativ në vijim konsiston në përllogaritjen e kështit të e kredisë duke konsideruar si principal vlerën 1,000,000 LEK/ EUR 10,000 dhe normat vjetore nominale të interesit respektive që Banka aplikon në monedhën LEK dhe EUR, këto të fundit sipas Kushteve të Punës në fuqi për Individë:

Afati	Monedha LEK		Monedha EUR	
	Normë interesi	Shuma e kështit LEK/ muaj	Normë interesi	Shuma e kështit EUR/ muaj
1 vit	4.2%	85,278	5%	857
3 vite	9%	31,880	7%	310
6 vite	9.5%	18,367	8.5% për 3 vitet e para 9.5% për vitet e mbetura	189 për 3 vitet e para 181 për vitet e mbetura
Shuma totale		LEK		EUR
1 vit		1,023,338		10,278
3 vite		1,147,685		11,148
6 vite		1,233,000		12,955
Vlera e interesit				
1 vit		23,338		278
3 vite		147,685		1,138
6 vite		233,000		2,955
Periodha e faljes për normën e interesit				N/A
Kamatvonesë për pagesën e vonuar të kështit				10%

Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës dhe menaxhimin e marrëdhënies kontraktore**Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës**

Komision për fonde të papërdorura	N/A
Ndryshimi i kontratës së kredisë	Falas
Pagesa të tjera	N/A
Komisioni i parapagimit	0.5% e shumës së parapaguar nëse periodha e mbetur deri në maturim është më e vogël se 1 vit; 1% e shumës së parapaguar nëse periodha e mbetur është më shumë se 1 vit.

Kostot dhe shpenzimet për menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë së Kredi personale	Sipas kushteve të punës për Individë
Komisioni i administrimit	2% e linjes; min 6,500 LEK; max 13,000 LEK 2% e linjes; min 50 EUR; max 100 EUR

Kostot e komunikimit

Kosto e komunikimeve ligjore shkresore	Falas
Kosto e komunikimeve ligjore online	Falas
Njoftim me shkrim për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	Nuk aplikohet
Njoftim elektronik (SMS) për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	50 Lekë/ muaj (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)
Amendimi i kontratës së Kredi personale	Falas EUR Falas LEK
Lëshimi i konfirmimit bankar	1,000 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)

Plani i amortizimit

Lloji i amortizimit	Francez
Lloji i kështit	I qëndrueshëm
Periodiciteti i pagesës së interesit	Çdo muaj

Ripagimi para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat**Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore**

Çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në Kontratën e Kredi personale (PL 100% Declared & Salary

ISBA) do të jetë efektiv pas miratimit me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e Kredi personale (PL 100% Declared & Salary ISBA) nuk do të jetë efektiv nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

Ankesat

Ankesat mund të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Me shkresë dërguar në Bankë me postë;
- Në degë tek "Kutia e ankesave & sugjerimeve" (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesat me shkrim nëpërmjet llogarisë së email-it në adresën zyrtare të website-it të Bankës si më poshtë:
complain@intesasanpaolobank.al
- Nëpërmjet qendrës së thirrjeve telefonie Call Center në numrin: 08006000

Afati kohor për përgjigjen nga ana e Bankës është maksimalisht 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

EURIBOR

Euro Interbank Offered Rate, norma e publikuar në sistemin Thomson Reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: <http://euribor-ebf.eu>

Bono Thesari

Treasury Bills do të thotë Interesi i Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove të Thesarit, të emëtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përlogaritjen mund të gjenden në faqen: www.bankofalbania.org